



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,
TREGËTISË DHE ENERJITIKËS

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË

Mesazhi i Ministrit



Për vitin 2007 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës prezanton një program të qartë e të integruar, një program të mbështetur në një perspektivë afatgjatë, ku proceset e buxhetimit vjetor janë kombinuar drejt me procesin e planifikimit strategjik dhe të buxhetimit afatmesem, një program ku për herë të parë janë përfshirë edhe kostot respektive të politikave të integritit euroatlantik.

I ndërtuar mbi objektiva të qarta e të matshme, programi i vitit 2007 synon me përparësi përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Programin e Qeverisë për fushat që mbulohen nga METE. Bazuar në këto objektiva METE parashikon që brenda vitit 2007 të përfundojë procesin e rishikimit të strategjive për sektorët e varësisë, të përgatisë dhe të paraqesë një kuadër politikash afatgjata për zhvillimin e sektorit energjetik, një kuadër politikash që garantojnë konkurrencën dhe eliminojnë diskriminimet në treg, që ofrojnë një klimë të volitshme për biznesin dhe investimet e huaja, që minimizojnë barrierat administrative dhe ulin koston e celjes së bizneseve, që garantojnë një proces të hapur dhe transparent në privatizimin e sektorëve strategjikë, duke synuar kështu që të permiresojë imazhin e Shqipërisë si një vend tërheqës si për biznesin e huaj ashtu dhe për biznesin vendas.

Inkurajimi i investimeve të huaja, si një instrument me kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike, do të jetë përparësi dhe do të vazhdojë të mbështetet përmes përsheptimit të procesit të privatizimit të sektorëve strategjike të vendit, si KESH, sektori i sigurimeve, nafta dhe gazi, përfshirë portet dhe aeroportet ku do të alokohen politikat e dhënies me koncesion. Paralelisht do të punohet për përmirësimin e kuadrit ligjor për tërheqjen e investimeve në sektorët energjetik dhe në zhvillimin e infrastrukturës në përgjithësi, do të nxiten të gjitha format e partneritetit me sektorin privat, si një mundësi për të gjeneruar burime shtesë në ekonomi dhe për të garantuar një ritëm të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik.

Gjate vitit 2007 METE do të intensifikojë procesin e bashkëpunimit me donatorët e huaj me synim rritjen e mobilizimit të burimeve financiare, do të synojë të zgjerojë dhe zhvillojë më tej proceset e bashkëpunimit mes vendit e rajonit e më gjerë, duke siguruar një harmonizim më të mirë të politikave të zhvillimit të vendit tonë me ato të vendeve të tjera të rajonit.

METE ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit mes vendeve të rajonit. Bashkëpunimin tregtar me këto vende, METE e sheh si një mundësi potenciale për të rritur volumin e shkëmbimeve tregtare dhe për të gjeneruar stabilitet ekonomik. Bashkëpunimi me vendet e rajonit edhe gjatë vitit 2007 do të zgjerohet më tej, ku me përparësi është parashikuar thellimi i bashkëpunimit në sektorin energjetik. Përafrimi i politikave të zhvillimit me këto vende do të mundësojë jo vetëm një përdorim më racional të burimeve energjetike të vendit, por edhe një menaxhim efikas të burimeve financiare të sektorit publik.

Shqipëria tashmë merr pjesë dhe është aktive në të gjitha iniciativat rajonale që kanë për synim rritjen e prosperitetit dhe zhvillimit ekonomik të rajonit në tërësi. Shqipëria prej kohësh është pjesë e proceseve integruese dhe liberalizuese të tregëtisë për Europën Juglindore. Shqipëria po zbaton me sukses të gjitha marrëveshjet e tregëtisë së lirë me vendet e Europës Jug-lindore, ka përparuar dhe nënshkruar marrëveshjen interim për tregti të lirë me Bashkimin Europian si dhe marrëveshjen e tregëtisë së lirë me Turqinë. Gjatë vitit 2007 proceset e bashkëpunimit do të thellohen më tej. Për vitin 2007 METE parashikon ratifikimin në Kuvend të një numri marrëveshjesh të rëndësishme, ndër të cilat marrëveshjen e tregëtisë së lirë me vendet e EFTA-s, marrëveshjen e tregëtisë së lirë me Turqinë, etj.

Përmes përmirësimit të klimës së biznesit dhe rregullimeve strukturore që do të bëhen në vitet në vazhdim, do të mundësohet rritja e mëtejshme e kreditimit të ekonomisë, ndërkohë që përmes përmirësimit të klimës së biznesit pritet që niveli i FDI-ve të rritet ndjeshëm në vitet në vazhdim.

Së fundi, do të theksojmë se programi i vitit 2007 përbën programin e parë të integruar të kësaj ministrie. Kjo eksperiencë në vitet në vazhdim do të përmirësohet më tej. Përmes rishikimit të programeve dhe politikave do të synohet rritja e efikasitetit të tyre në përmbushjen e objektivit kryesor të Programit të Qeverisë: mundësimi dhe ruajtja e një norme të rritjes ekonomike prej 6% dhe në perspektivë edhe tejkalimin e saj.



Genc Ruli

Ministër i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	3
3	Programet buxhetore të Ministrisë	6
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	8
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	13
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur	14
Aneks 2	Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë	15
Aneks 3	Rezultate që lidhën me integrimin European	16
Aneks 4	Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO	17
Aneks 5	Investimet publike	18
Aneks 6	Projekte të ndihmës së huaj	19

1 Misioni i Ministrisë

Harton dhe zbaton politika që nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, që mundësojnë zhvillimin e biznesit vendas dhe terheqjen e investimeve të huaja, që garantojnë konkurrencën dhe një treg të sigurtë, që sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm e perspektiv të burimeve energjetike të vendit, që nxisin bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar, që realizojnë mirë administrimin e pronës publike në funksion të privatizimit të saj në sektorët strategjike dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e ekonomisë (Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve)

Eshte pergatitur drafti i Strategjise i Strategjise se Zhvillimit te Biznesit dhe Investimeve (Strategjia e Ekonomise). Dokumenti eshte pergatitur nga grupi teknik i punes, i cili eshte asistuar nga nje konsulent ndekombetar dhe nje konsulent lokal. Drafti ka kaluar procedurat e shqyrtimit paraprak nga DBSKSNH ne Keshillin e Ministrave, eshte konsultuar me Grupin Keshillimor te kesaj strategjie, i cili perfshin grupet kryesore te interesit si dhe nje numer rrethesh akademike te vendit, verejtjet e te cileve jane reflektuar ne kete dokument nga Grupi Teknik i Punes. Dokumenti eshte hartuar ne perputhje me udhezimet e percaktuara ne manualin teknik per hartimin e strategjive sektoriale, te nxjerre nga DBSKSNH prane Keshillit te Ministrave ne zbatim te Urdherit te Kryeministrit Nr. 134, date 12.6.2006 "Per pergatitjen dhe hartimin e Strategjise Kombetare per Zhvillim dhe Integrim.

Ne perputhje me planin e pergatitjes se kesaj strategjie, dokumenti eshte paraqitur per shqyrtim ne Grupin e Punes per Strategji, Buxhet dhe Integrim. Ne vijim ky dokument eshte parashikuar te konsultohet me Keshillin Konsultativ te Biznesit, dhe me tej do t'ju paraqitet per mendim ministrive te interesuara. Pas mbledhjes dhe reflektimit te komenteve dhe sugjerimeve te tyre, drafti perfundimtar do te dergohet per shqyrtim ne DBSKSNH ne Keshillin e Ministrave dhe me pas ne perputhje me rekomandimet e DBSKSNH do te dergohet per miratim ne Qeveri.

Drafti i strategjise se Ekonomise (Strategjia e Zhvillimit te Biznesit dhe Investimeve) perfshin edhe masat qe do te ndermerren ne kuader te reformes rregullatore per permiresimin e klimes se biznesit ne Shqiperi duke synuar ne menyre te vecante nje zhvillim te shpejte te SME-ve, rritjen e eksporteve dhe terheqjen e investimeve te huaja ne vend. Plani i veprimit te reformes rregullatore, e cila menaxhohet dhe koordinohet nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, parashikon trajtimin e dy ceshtjeve mjaft te rendesishme si regjistrimi i biznesit dhe licensimi, te cilat aktualisht po asistohen nga Qeveria Amerikane nepermjet programit Sfida e Mijevjecarit per Shqiperine dhe Bankes Boterore, rekomandimet e te cileve jane pjese integrale e ketij dokumenti.

Strategjia sektoriale e energjise

Strategjia Kombetare e Energjise eshte pergatitur per here te pare ne vitin 2003. Ne vendimin qe ka miratuar kete strategji eshte lene si detyre qe kjo strategji te perditesohet cdo dy vjet. Rishikimi i strategjise eshte rregulluar me Urdherin e Kryeministrit Nr.133, date 8.8.2006.

Aktualisht ka perfunduar materiali bazik i strategjise se perditesuar dhe eshte paraqitur per verejtje dhe sugjerime ne Keshillin e Ministrave. Eshte duke u punuar per kapitujt e vecante te saj, ne menyre qe strategjia e perditesuar e energjise te perbeje nje dokument te plote lidhur me rekomandimet per zhvillimin e ardhshem te ketij sektori.

Konform Urdherit te Kryeministrit, parashikohet qe perditesimi i Strategjise Kombetare te Energjise te perfundojone ne muajin Prill 2007.

Strategjia ndërsektoriale e zhvillimit rajonal

Strategjia Ndërsektoriale per Zhvillimin Rajonal pergatitet ne bashkepunim me nje numer ministrish, ku METE ka rolin kryesues ne pergatitjen e kesaj strategjie. Synon perpunimin e nje kuadri politikash qe mundeson nje zhvillim te qendrueshem e te balancuar ndermjet rajoneve te vendit ne pergjithesi, dhe ne vecanti te zonave malore dhe periferike.

Draft bazik i Strategjise Ndërsektoriale per Zhvillimin Rajonal se bashku me Plan-Vepimin 2007-2008 per perfundimin dhe pergatitjet per zbatimin e SNZHR, i jane derguar per DBSKSNH ne daten 25.10.2006. Me iniciativen dhe kerkesen e Z. Genc RULI, Minister i METE, gjate vitit 2006 u

pergatit edhe nje plan-veprimi per muajt Nentor-Dhjetor 2006, per realizimin e aktiviteteve te meposhtme:

- Organizimi dhe zhvillimi ne datat 27 Nentor, 1 Dhjetor, 5 Dhjetor, 8 Dhjetor dhe 14 Dhjetor 2006 i 5 workshop-eve me perfaqesues dhe aktore ne nivel qendror, rajonal e lokal, nga sektori publik, sektori privat, agjenci donatore dhe shoqeria civile per njohjen me draft-dokumentin e SNZHR.
- Ngritja dhe aktivizimi i Grupit te Punes per percaktimin e indikatorëve qe do te sherbejne per vleresimin e nivelit te zhvillimit socio-ekonomik te qarqeve dhe klasifikimin e tyre, me synim identifikimin e zonave te pafavorizuara.
- Pergatitja e nje raporti mbi iniciativat dhe aktivitetin e agjencive te ndryshme donatore ne lidhje me zhvillimin rajonal dhe lokal.

Dokumenti i plote i te SNZHR parashikohet te perfundoje ne fund te vitit 2007. Pergatitja e ketij dokumenti eshte asistuar nga UNDP.

Strategjia ndërsektoriale e mbrojtjes së konsumatorit

Strategjia Ndersektoriale per Mbrojtjen e Konsumatoreve dhe Mbikqyrjen e Tregut synon sigurimin e nje niveli te larte te sigurise se produkteve ne treg dhe mbrojtjen e interesave ekonomike te konsumatoreve.

Ne vitin 2006 Drejtoria e Mbikqyrjes se Tregut perfundoi hartimin e dokumentit afatmesem te Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut per periudhen 2006 - 2008. Ne mbledhjen e Keshillit te Ministrave te dates 26 Gusht 2006 u vendos pezullimi i kesaj strategjie dhe ngritja e nje grupi pune nderministror te kryesuar nga Zevendeskrjeminstri per hartimin e nje Strategji Ndersektoriale afatgjate dhe gjithepershiresë per fushen industriale dhe ushqimore.

Per hartimin e kesaj strategjie eshte ngritur nje Grup Nderministror nen drejtimin e ZV/Kryeministrit, ku METE dhe MBUMK kane rolin udheheqes. Ne mbledhjen e fundit te grupit teknik te punes u vendos qe kjo strategji te konceptohet e ndare ne dy komponente: fusha ushqimore dhe ajo industriale. Komponenti per mbrojtjen e konsumatoreve per produktet ushqimore do te hartohet nga MBUMK dhe MSH, ndersa ai i produkteve industriale dhe i mbrojtjes se intereseva ekonomike te konsumatoreve nga METE.

Drafti i pare i kesaj strategjie do te diskutohet ne javen e dyte te Marsit ne Grupin Nderministror. Dokumenti i plote parashikohet te perfundoje ne Shtator 2007.

Qëllimet

Politikat e METE-s synojne te kontribojne ne arritjen e qellimeve te meposhtme afatgjata:

- Krijimi i nje stafi te kualifikuar qe mundeson realizimin e objektivave afatgjata te METE-s. Politikat qe do te ndiqen per kete qellim jane: trajnimi dhe ri-trajnimi i personelit te ministrise dhe institucioneve te varesise, permiresimi i procesit te rekrutimit, perdorimi me eficience i burimeve njerezore e financiare te METE.
- Permiresimi i eficiences se administrimit te burimeve energjitike dhe standarteve te furnizimit me energji elektrike: Politikat qe do te ndiqen jane: permiresimi i kuadrit te politikave te zhvillimit te sektorit te energjise elektrike, permiresimi i kuadrit ligjor e institucional, realizimi i marreveshjeve te bashkepunimit me donatore te ndryshem per rritjen e investimeve ne kete sektor, rritja e bashkepunimit me sektorin privat vendas apo te huaj per terheqjen e investimeve ne kete sektor, rritja e efektivitetit te perdorimit te energjise elektrike permes futjes se burimeve alternative te energjise dhe rritjes se kapaciteteve te shkembimit te energjise, forcimi i kontrollit dhe monitorimit te sektorit te energjise elektrike nga strukturat e specializuara te METE.

- Garantimi i furnizimit të tregut me produkte hidrokarbure. Politikat që do të ndiqen për realizimin e këtij qëllimi janë: diversifikimi i burimeve të furnizimit, hartimi i politikave që mundësojnë një zhvillim perspektiv dhe afatgjatë të tregut të produkteve hidrokarbure, lidhja e vendit të tone me rrjetin rajonal dhe ndërkombëtar të naftës dhe të gazit, përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në sektorin hidrokarbur dhe në vecanti të tregut të gazit natyror në vendin të tone, përgatitja e studimeve komplekse për rritjen e mirëadministrimit të territorit dhe burimeve natyrore në fushën e gjeomjedisit dhe zonat e industrisë së naftës, diseminimi i informacionit të shkencave hidrokarbure.
- Identifikimi, studimi dhe shfrytëzimi racional i burimeve nëntokesore të vendit. Politikat që do të ndiqen për arritjen e këtij qëllimi janë: monitorimi dhe vlerësimi i ujërave nëntokesore në basenet kryesore ujëmbajtës me përparësi zonat turistike dhe urbane, realizimi i studimeve komplekse në fushën e gjeomjedisit, studime për mirëadministrimin e territorit dhe burimeve natyrore, zhvillimi i sistemeve të informacionit dhe bankës së të dhënave për disiplinat e ndryshme të shkencave të tokës, përmirësimi i procedurave për shfrytëzimin e burimeve, monitorimi i fenomeneve të post shfrytëzimit të minierave, evidentimi i zonave problematike dhe menjanimi i tyre, përpilimi gradual i një harte për zonat me rreziqe minerare, etj.
- Garantimi i një strukture minerare efikente nga pikepamja ekonomike të mireorientuar në treg dhe që inkurajon zhvillimin dhe rritjen e prodhimit vendas. Politikat afatmesme që do të ndiqen për realizimin e këtij qëllimi janë: Mbyllja provizore e minierave të kromit, bakrit, qymyrgurit, hekur-nikelit, si dhe të objekteve ku janë kryer punime gjeologjike, etj, të cilat nuk paraqesin aktualisht apo përfundimisht interes për shfrytëzim, shmangja e rreziqeve për banorët dhe ambientin për rreth, demtimeve në infrastrukturën e zonës, minimizimi shpenzimeve për hapjen e minierave në rast interesi. Rimbjllja e punimeve minerare të cilat do të konstatohen të hapura gjatë monitorimit. Konservimi i objekteve për të krijuar mundësinë e vazhdimit normal të procesit të privatizimit të aseteve të objekteve minerare dhe të industrisë prodhuese, likuidimi ose abandonimi i tyre, n.q.s nuk arrihet të privatizohen.
- Nxitja e sipërmarrjes, produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së biznesit në Shqipëri. Politikat që do të ndiqen për realizimin e këtij qëllimi janë: Përmirësimi i pershpejtuar i klimes për zhvillimin e biznesit, reduktimi i informalitetit në ekonomi, reduktimi të barrierave administrative, përmirësimi i ambjentit rregullator, nxitja e prodhimeve për eksport, terheqja e investimeve të huaja, stimulimi i teknologjive të reja të prodhimit, që rrisin konkurrueshmërinë e prodhimit dhe shërbimeve, përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullator në fushën e biznesit dhe investimeve, krijimi i një partneriteti të qëndrueshëm me sektorin privat, lidhja e shërbimeve publike të formimit profesional me nevojat perspektive të biznesit.
- Rritja e sigurisë së mallrave dhe shërbimeve në treg. Politikat që do të ndiqen për realizimin e këtij qëllimi janë: krijimi dhe harmonizimi i kudit rregullator për produktet dhe shërbimet, krijimi i një Sistemi të vertetë të Mbikqyrjes së Tregut koordinimi dhe bashkërendimi i veprimtarive të strukturave publike të kontrollit të tregut, sigurimi i një infrastrukture të përshtatshme dhe personeli të trajnuar, adoptimi i një plani pune të bazuar për anëtarësim të ardhshëm në EA, përmirësimi i funksionimit të levizjes së lire të mallrave duke patur në konsideratë praktikën me të mira të BE-së.
- Maksimizimi i vlerës së përdorimit të aseteve shtetërore. Politikat që do të ndiqen për këtë qëllim janë: ristrukturimi dhe privatizimi i shoqërive shtetërore të sektoreve strategjike, me prioritet sektoret e energjisë elektroke, të naftës dhe gazit, si dhe privatizimin e shoqërive me kapital shtetëror dhe aseteve të Sektorit Jostrategjik (SME-ve).

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM

Programi synon mbështetjen me burime financiare dhe materiale të aparatit të Ministrisë për përmbushjen e funksioneve të saj dhe realizimin e objektivave të saj në kuadër të Programit të Qeverisë 2005-09. Programi përfshin shpenzimet për paga e sigurime dhe ato operacionale për funksionimin e aparatit dhe institucioneve të varesise, shpenzime të vogla për investime në pajisje apo rikonstruksione të vogla. Shpenzimet për këtë program zënë rreth 9,5% të shpenzimeve gjithsej.

3.2 MBESHTETJE PËR ENERGJINE

Programi ka si objektive krijimin e premisave rregullatore dhe ligjore që mundësojnë një furnizimin të pandërprerë dhe cilësor të konsumatorëve me energji elektrike dhe produkte hidrokarbure. Programi përfshin shpenzimet korrente dhe ato kapitale për Policinë Elektrike, Agjencinë Kombëtare të Energjisë, projekte studimore gjeologjiko-gjeofizike për evidentimin dhe prognozimin e strukturave hidrokarburmbajtëse, studime për diversifikimin e burimeve të furnizimit për një zhvillim perspektiv të tregut të produkteve hidrokarbure, lidhjen e vendit të naftës me rrjetin ndërkombëtar të gazit dhe të naftës, si dhe për përmirësimin e kuadrit rregullator në sektorin hidrokarbur dhe në vecanti kompletimi i kuadrit rregullator të tregut të gazit natyror në vendin të naftës. Projektet me financim të huaj që zbatohen nga KESH sh.a. për vitin 2007 nuk përfshihen në këtë program.

3.3 MBESHTETJE GJEOSHKENCA DHE TË TJERA

Politika e këtij programi synon në mbrojtjen dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve nëntokësore të vendit. Programi konsiston në studime dhe projektme në fushën e gjeoshkencave, të nevojshme për zhvillimin e harmonizuar ekonomik, mjedisor dhe social të vendit. Në funksion të kësaj politike, programi për gjeoshkencat siguron një informacion të domosdoshëm për një numër sektorësh të tjerë, duke lehtësuar vendimmarrjen në të gjitha nivelet, përfshirë plotësimin e nevojave të komunitetit. Programi përfshin financimet nga buxheti i shtetit të parashikuara për Sherbimin Gjeologjik Shqiptar dhe Agjencinë Kombëtare e Burimeve Natyrore.

3.4 MBESHTETJE MINIERA E NDERMARRJE PUBLIKE

Politika e këtij programi konsiston në monitorimin e minierave të mbyllura, ka për qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit në zonat minerare të shfrytëzuara, privatizimin apo likuidimin e aseteve të këtij sektori (industrite prodhuese) në përputhje me politikën e qeverisë. Programi përfshin shpenzimet për Repartin e Inspektimit Shpëtim Minier, shpenzimet kapitale të pa trupezuara që kanë si destinacion mbylljen, likuidimin apo konservimin e minierave ose ndërmarrjeve të parashikuara për mbyllje. Programi financohet tërësisht me financim të brendshëm.

3.5 MBESHTETJE PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Programi synon në përmirësimin e klimës së biznesit dhe investimeve në Shqipëri. Parashikon një seri aktivitësh që lidhen me përmirësimin e kuadrit rregullator dhe institucional, hartimin dhe monitorimin e politikave për zhvillimin e sektorit privat, për zhvillimin e politikave të tregut, garantimin e konkurrencës së ndershme, thjeshtësimin dhe standartizimin e praktikave të biznesit në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, zhvillimin e politikave në fushën e mbrojtjes së konsumatorit; zhvillimin e politikave sektoriale, platformave dhe programeve për përmirësimin e menaxhimit të shoqërive tregtare me kapital shtetëror nëpërmjet koordinimit të procesit të privatizimit me ristrukturimin e tregjeve perkates dhe shoqërive shtetërore.

Ne sektorin e privatizimit programi synon maksimizimin e vlerës së përdorimit të asetëve shtetërore, nëpërmjet procesit të dhënies me qira ose enfi-teoze të objekteve prone shtetërore dhe monitorimit të kontratave të qirave dhe enfi-teozes. Përsosja e menaxhimit të shoqërive që veprojnë në sektoret strategjike dhe realizimi i procesit të ristrukturimit dhe privatizimit të këtyre shoqërive. Sigurimi i së drejtës së parablerjes për pronarët, sipas ligjit "Për Kthimin dhe Kom-pesimin të Pronave" në privatizimin e asetëve shtetërore.

Programi përfshin financimet nga buxheti të parashikuara për Agjencinë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve (Albinvest), projekte me financim të huaj apo të brendshëm me objekt mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të SME-ve, mbështetjen e reformave rregullatore, përmirësimin e kuadrit ligjor e institucional për zhvillimin e sektorit privat në përgjithësi.

3.6 SHERBIMET E TREGUT, AKREDITIM DHE INSPEKTIM

Programi synon në mbështetjen dhe aftësimin e shërbimeve të inspektimit, që është pjesë përbërëse e politikave të Qeverisë për mbikqyrjen së tregut. Programi ka për qëllim arritjen e një shkalle të lartë sigurie të produkteve të vendosura në treg, mbrojtjen e interesave ekonomike dhe të drejtave të tjera të konsumatorëve, rritjen e shkalles së zbatueshmërisë së përdorimit të rregullave teknike në fuqi, mbështetjen e institucioneve të varesisë për zhvillimin e një infrastrukture çilesore lidhur me shërbimet e akreditimit dhe inspektimit.

Programi përfshin fondet buxhetore të destinuara për ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve në Inspektoriatin e Përgjithshëm Shtetëror, (krijuar nga ristrukturimi i Inspektoriatit Shtetëror të Kontrollit të Naftës dhe Gazit, Inspektoriatit të Eneve nën Presion, Inspektoriatit të Pajisjeve Elektrike dhe Institutit të Industrisë së Lehtë), Drejtorinë e Akreditimit dhe Drejtorinë e Patentave dhe Markave.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2007. Këto produkte përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM

Objektivat e politikës

- Krijimi i nje stafi te kualifikuar qe mundeson realizimin e objektivave afatgjata te METE-s, trajnimi dhe ri-trajnimi i personelit te ministrise dhe institucioneve te varesise, permiresimi i procesit te rekrutimit, perdorimi me eficience i burimeve njerezore e financiare te METE, zbatimi i planit afatshkurter te perafimit te legjislacionit.

Produktet qe do te ofrohen

- Menaxhim, planifikim dhe administrim i permiresuar
- Kushtet e punes te permiresuara, personel me i kualifikuar

4.2 MBESHTETJE PER ENERGJINE

Objektivat e politikës

- Hartimi i politikave, kuadrit ligjor si dhe organizmi i strukturave per privatizimin e sh.a KESH. Rishikimi i Strategjise Kombetare te Energjise per ta pershtatur me politikat qeverises dhe zhvillimet e koheve te fundit ne sektorin e energjise. Arritja e marreveshjeve te bashkepunimit me donatore te ndryshem per te terhequr investime ne sektorin elektrik, permiresimi i cilesise se monitorimit dhe kontrollit.
- Rekomandime konkrete per burime energjitike me baze hidrokarbure nepermjet studimeve gjeologo-gjeofizike, si dhe rritja e mundesive per thithjen e investimeve te huaja per zbulimin e rezervave te reja te naftes dhe te gazit.
- Studime per mundesine e lidhjes se Shqiperise me rrjetin nderkombetar te naftes e gazesjellsave vecanerisht me ato te Europes Juglindore duke projektuar gjurmet perkatese te kalimit te tyre ne territorin Shqiptar, mundesise se stokimit te gazit natyror ne Shqiperi si dhe ndertimit te terminaleve bregdetare te GLN ne qarkun e Fierit. Studim njohes i kuadrit rregullator te tregut te gazit ne vendet e BE per fillimin e pergatitjes se kuadrit rregullator per zhvillimin e tregut te gazit ne vendin tone.
- Studimi i gjeomjedisit dhe monitorimi i tij ne zonat me aktivitet hidrokarbur ne qarkun e Fierit e Vlores duke propozuar masa parandaluese dhe rehabilituese ne ndihme te vendim-marrjes.
- Studimi mbi bazen e te dhenave per komponente te ndryshem: gjeologji, lende te para, hidrogjeologji, gjeologji inxhinjrike etj. dhe rekomandime per zhvillim te harmonizuar e te qendrueshem te territorit dhe shfrytezim racional i burimeve natyrore ne qarkun e Fierit.
- Optimizimi dhe zgjerimi i tregut te nenprodukteve hidrokarbure duke percaktuar nje shperndarje me racionale te stacioneve te shitjes me shumice dhe pakice ne te gjithe territorin e Shqiperise sipas nevojave dhe kushteve konkrete dhe mundesite e zgjerimit te perdorimit te gazit te lengezuar te naftes ne industri, sherbimet komunale dhe bujqesi.
- Percaktimi i rezervave te naftes dhe gazit ne perputhje me standartet e BE.
- Studimi i gjendjes aktuale te etapes se shfrytezimit te 4 vendburimeve hidrokarbure duke vleresuar kapacitetin dhenes per secilin rezervuar ne kushtet edhe te aplikimit te teknologjive te reja bashkekohore per rritjen e prodhimit dhe uljen e koston.

Produktet qe do te ofrohen

- Nje strategji kombetare e perditeluar per energjine
- Rritja e kapaciteteve prodhuese te energjise elektrike nga TEC-et ekzistues;
- Permiresimi i kuadrit ligjor per lehtesirat fiskale dhe financiare per ndertimin dhe operimin e burimeve te prodhimit te energjise perfshire dhe autoprodhuesit;
- Politika tarifore ne hartimin e PPA dhe percaktimi i formulave te mundshme.
- Permiresim i eficiences se energjise dhe mbeshtja e sektorit privat.
- Nje Model te Tregut te energjise elektrike;
- Rishikimi i Kodit te Transmetimit dhe kodeve te tjera.
- Ristrukturimi i KESH sh.a dhe pergatitja e procedurave per privatizimin e sektorit te shperndarjes se energjise elektrike.
- Ristrukturimi i shoqerive Albpetrol sh.a dhe Servcom sh.a dhe privatizimi i shoqerise ARMO Sh.a
- Fillimi i zbatimit te projekteve per lidhjen e Shqiperise me rrjetin e naftesjellesave nderkombetare (AMBO) dhe gazsjellesave (Projekti EGL).
- Miratimi i te gjitha procedurave ligjore per te bere te mundur nxitjen e interesit per ndertimin e depozitave te GLN ne qarkun e Fierit;
- Ndertimi i kuadrit ligjor dhe teknik per tregun e gazit ne territorin shqiptar;
- Percaktimi i metodave me optimale per shfrytezimin e vendburimeve te naftes dhe gazit si dhe llogaritjen e rezervave te nxjerrshme te tyre sipas standarteve te BE si dhe bashkepunimi me shoqerite e huaja per rritjen e prodhimit vendas nepermjet perdorimit te metodave bashkekohore te nxjerrjes se naftes.

4.3 MBESHTETJE GJEOSHKENCA E TE TJERA

Objektivat e politikës

- Studimi i ujrave nentokesore dhe rezurseve minerare, permiresimi i administrimit te territorit dhe burimeve natyrore; monitorimi i gjeomjedisit dhe shmangia e rreziqeve gjeologjike.
- Permiresimi i sistemit te informacionit; Studime dhe projektme per nevoja emergjente sipas kerkesave te pushtetit lokal; promovimi i mineraleve te rinj per shfrytezim;
- Mbikqyrja e Shfrytezimit Efektiv te Pasurive Minerale; Monitorimi i Fenomeneve Post Shfrytezimit dhe uzinave metalurgjike; Perpunimi i direktivave BE.

Produktet qe do te ofrohen

- Studime dhe projekte per nevoja emergjente te Pushtetit Lokal e Qendror, per rreshqitje dherash.
- Percaktimi i treguesve hidro-gjeologjike ne rrjetin monitorues, hartimi i rekomandimeve per regjimet optimale te shfrytezimit te ujrave nentokesore, hartimi i projekteve per furnizimin me uje te zonave rurale, urbane e turistike.
- Rajonizime gjeologo inxhinjerike ne shk. 1:10 000 Laç, Mamurras, Milot, Peshkopi, vleresim dhe monitorim te qendrueshmerise se infrastruktures, monitorimi fenomeveve gjeologjike.
- Plotesimi bankes se te dhenave te Arkivit Qendror te Gjeologjise, akses i shpejte i perdoruesve te ndryshem per informacion ne fushen e gjeoshkencave, si dhe transmetim te dhenash.
- Mbikqyrja e shfrytezimit te rezervave minerare nga subjektet private si dhe modelimi i masivit ultrabazik te Bulqizes

- Strategjia e përdorimit të mineraleve të rinj.
- Hartime dhe amendimi i ligjeve, raporte monitorimi, studime, harta ambientale, raporte informacioni.

4.4 MBESHTETJE MINIERA E NDERMARRJE PUBLIKE

Objektivat e politikës

- Vazhdimi i mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe jo efektive, privatizimi i aseteve për minierat e kromit, bakrit, hekurnikelit dhe qymyreve, gjithsej rreth 35 miniera.
- Monitorimi dhe kontrolli i specializuar i objekteve minerare dhe masat për eliminimin e rreziqeve.
- Konservimi dhe privatizimi i aseteve të industrisë prodhuese.

Produktet që do të ofrohen

- Asete të privatizuara
- Miniera të mbyllura

4.5 MBESHTETJE PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Objektivat e politikës

- Hartimi i strategjisë së zhvillimit ekonomik (të biznesit dhe investimeve)
- Hartimi i programit strategjik afatmesëm për zhvillimin e SME-ve në kontekstin e rritjes së konkurrueshmërisë; zbatimi i planit të veprimit për reduktimin e ekonomisë informale;
- Hartimi i programit të masave për nxitjen e eksporteve, krijimi i fondit të konkurrueshmërisë për mbështetjen e SME-ve eksportuese; rishikimi i strategjisë dhe kuadrit ligjor për nxitjen e investimeve, (ligji i ri i koncesioneve si dhe hartimi i akteve të tjera nenligjore në zbatim të tij);
- Zbatimi i objektivave të Kartës Europiane të SME-ve për periudhën 2006-2007 si dhe vlerësimi i politikave për SME-të sipas indeksit të politikave të SME-ve
- Vlerësimi dhe monitorimi i politikave për investime sipas indeksit të reformës në investime
- Krijimi i sistemit të menaxhimit të reformës Rregullatore nepermjet krijimit të strukturës përgjegjëse për menaxhimin, kordinimin dhe monitorimin e reformës rregullatore:
 - Konsolidimi i sektorit të ri të krijuar për ndjekjen dhe monitorimin e Reformës Rregullatore;
 - Hartimi i Planit të ri të Veprimit të Reformës Rregullatore për përmirësimin e klimës së biznesit;
 - Krijimi i Qendres Kombëtare të Regjistrimit dhe fillimi i procesit të regjistrimit të biznesit në një pikë të vetme.
 - Krijimi i kuadrit institucional dhe ligjor për garantimin e cilësisë rregullatore.
 - Thëllimi i procesit të eliminimit të procedurave administrative të panevojshme të licencimit dhe krijimi i një kuadri gjithëpërfshirës për të, në përputhje me "acquis communautaire" dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare.
- Mbeshtetja e shoqatave të konsumatorëve në Shqipëri nepermjet trajnimeve, programeve apo forma të tjera mbështetjeje;

- Forcimi i kapaciteteve institucionale të drejtorise së politikave tregtare; krijimi i sistemit të monitorimit të të drejtave shtetërore mbi pronën shtetërore dhe procesit të transferimit të këtyre të drejtave sektorit privat, nëpërmjet formave ligjore të privatizimit

Produktet që do të ofrohen

- Një strategji e rishikuar për zhvillimin e biznesit dhe nxitjen e investimeve
- SME të fuqizuara, të kredituara dhe me konkuresë
- Krijimi i fondit të garantimit për SME-të
- Kuader rregullator i përmirësuar
- Rritje të nivelit të eksporteve
- Reduktimi i kohës dhe kostos së regjistrimit të biznesit
- Reduktim i numrit të licencave, lejeve, autorizimeve të panevojshme, procedura të lehtësuara
- Krijimi i fondit për rritjen e konkureshmerisë së SME-ve që eksportojnë
- Adoptim i kuadrit ligjor në fushën e SME-ve dhe biznesit me direktivat e BE-së
- Plani strategjik afatmesëm për zhvillimin e SME-ve dhe vlerësimi i kostos për zbatimin e këtij plani
- Institucionalizimi i dialogut Qeveri Biznes nëpërmjet krijimit të Sekretariatit të Këshillit Konsultativ të Biznesit
- Plani i masave për RIA;
- Ngritja e Qendres Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve
- Harmonizimi i sistemit të licensimit sipas fushave në përputhje me *acquis communautaire*.
- Sensibilizimi i konsumatorëve mbi të drejtat e tyre

4.6 SHERBIMET E TREGUT, AKREDITIM DHE INSPEKTIM

Objektivat e politikës

- Hartimi i politikave dhe kuadrit rregullator për levizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve, mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe mbikqyrjen e tregut
- Institucionalizimi i Sistemit të Mbikqyrjes së Tregut sipas konceptit evropian
- Forcimi i kapaciteteve të strukturs së mbikqyrjes së tregut
- Infrastruktura e përshtatshme, personel i trajnuar dhe adoptimi i një plani pune të bazuar për anëtarësimin në BE

Produktet që do të ofrohen

- Një strategji e rishikuar për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut
- Kuader rregullator i përmirësuar
- Funksionimi efektiv i mbikqyrjes së tregut
- Përmirësim i ndjeshëm në drejtim të sigurisë së produkteve dhe shërbimeve në treg

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, million Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqerore 600, 601	Mallra dhe sherbime 602	Subveconet 603	Te tjera transferte korrente 604, 605	Transferta per buxhetet familiare dhe individet 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	190	85	0	70	0	26	372
Mbeshtetje per energjine	148	20	0	0	0	20	188
Mbeshtetje gjeoshkenca e te tjera	0	0	0	0	0	222	222
Mbeshtetje miniera e ndermarrje publike	30	5	0	0	0	69	104
Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	30	30	0	0	0	1 600	1 660
Sherbimet e tregut, akreditim dhe inspektim	101	45	0	0	0	13	159
Total	500	185	0	71	0	1 950	2 706

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi		
Numri i trajnimeve të marra nga stafi i Ministrisë	Sesionet	80
Mbeshtetje për energji		
Projekte të realizuara në nivelin e programuar në sektorin elektrik		5
Fillimi i procedurave për dhenien me koncesion të TEC-it të Fierit		Plotesimi i kuadrit ligjor
Perfundimi i ligjit për dhenien me koncesion të HEC-eve të vegjël		Miratimi i paketës ligjore
Rrija e prodhimit të nxjerrjes së naftës	%	10
Miratimi i akteve ligjore për fillimin e ndertimit të naftesjellesave	Pakete koncesionare	1
Nenshkrimi i marrëveshjeve hidrokarbure		2
Nxjerrja e akteve ligjore dhe nenligjore për tregun e gazit	Ligj	1
Mbeshtetje miniera e ndërmarrje publike		
Shkrimi i shoqërive/ndërmarrjeve minerare	Miniera të mbyllura	11
Mbeshtetje për zhvillim ekonomik		
Shuma e kreditimit për SME	% PBB-së	25
Niveli i eksporteve	€ milion	674
Niveli i investimeve të huaja	€ milion	410
Koha e regjistrimit të biznesit	Dite	5
Pergatitja e paketës ligjore për regjistrimin e biznesit	Ligj	1
	VKM	3
Numri i masave të realizuara nga plani i veprimeve për reduktimin e ekonomisë informale	Masa	12
Rritja e numrit të ndërmarrjeve të reja që hyjnë në treg	%	15
Sherbimet e tregut, akreditim dhe inspektim		
Pergatitja e kuadrit të nevojshëm ligjor në fushën e sigurisë së mallrave dhe shërbimeve	Ligj	2
	VKM	1

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

- Projekt-ligji "Per zhvillimin rajonal" (ne kuadrin e SNZHR)
- Projekt-ligji "Per sigurine e pergjithshme, kerkesat thelbesore dhe vleresimin e konformitetit per produktet"
- Projekt-ligji "Per koncensionet e hidrocentraleve te vegjel"
- Projekt-ligji "Per disa ndryshime ne ligjin per qirane financiare"
- Projekt-ligji "Per privatizimin e sektorit te shperndarjes te energjise elektrike"
- Projekt-ligji "Per shitblerjen e energjise elektrike"
- Projekt-ligji "Per ngritjen e Qendres Kombetare te Regjistrimit, QKR"
- Projekt-ligji "Per amendamente ndaj marreveshjes TRIPS"
- Projekt-ligji "Per mekanizmin e transparences per marreveshjet tregtare rajonale"
- Projekt-ligji "Per marreveshjen e tregtise se lire me EFTA"
- Projekt-ligji "Per zhvillimin e zonave ekonomike"
- Projekt-ligji "Per industrine"
- Projekt-ligji "Ligji minerar"
- Projekt-ligji "Per prodhimin dhe perdorimin e biokarburanteve"
- Projekt-ligji "Per tregun e gazit ne Shqiperi"
- Projekt-ligji "Per amendime ne ligjin per Sherbimin Gjeologjik Shqiptar"
- Projekt-ligji "Per ratifikimin e konventes trepaleshe ndermjet Republikes se Shqiperise, Republikes se Bullgarise dhe Republikes se Maqedonise, per sistemin e naftesjellesit transballkanik"
- Projekt-ligji "Per ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.8701, date 01.12.2000 "Per lojerat e fatit, kazinote dhe hipodromet", te ndryshuar
- Projekt-ligji "Per amendime ne ligjin "Per mbrojtjen e konsumatorit"
- Projekt-ligji "Per amendime ne ligjin "Per barret siguroese"
- Projekt-ligji "Per metrologjine"
- Projekt-ligji "Per amendime ne ligjin "Per policine elektrike"

Aneks 2 Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë

Angazhimet ne Programin e Qeverise	Outputet
Rritje dhe fuqizim te kapaciteteve institucionale	Manaxhim, planifikim dhe administrim i permiresuar Kushte te punes te permiresuara
Energji e mjaftueshme, e lire dhe e garantuar	Metoda me optimale per shfrytezimin e vendburimeve te naftes dhe gazit si dhe llogaritjen e rezervave te nxjerrshme te tyre sipas standarteve te BE-se Marreveshje bashkepunimi me shoqerite e huaja per rritjen e prodhimit vendas nepermjet perdorimit te metodave bashkohore te nxjerrjes se naftes Nje kuadrit ligjor i permiresuar per lehtesirat fiskale dhe financiare per ndertimin dhe operimin e burimeve te prodhimit te energjise elektrike, perfshire dhe autoproduhuesi Politika tarifore ne hartimin e PPA dhe percaktimi i formulave te mundshme
Fuqizimi sistemit elektroenergjetik	Fillimi i punimeve ne linjen 400 kV te interkonjeksionit te Elbasan-Podgorice Fillimi i punimeve per ndertimin e TEC-it te Vlores Fillimi ndertimit te Qendres se Re Dispeçer, fillimi i punimeve te ndertimit te N/St 400 kV Tirane. Politika te permiresuara per stimulimin e prodhimit nga HEC-et e vegjel
Ristrukturimi dhe privatizimi I KESH	Konsolidimin e ndarjes se Sh.a. OST nga Sh.a.KESH-i; Ristrukturimi i KESH sh.a dhe fillimi i procedurave per privatizimin e sektorit te shperndarjes se energjise elektrike; Krijimi i strukturave drejtuese dhe hartimi i statutit te OSSH.
Ristrukturimi dhe privatizimi i shoqerive te sektorit te naftes	Ristrukturimi Albpetrol Sha dhe Servcom Sha, privatizimi i shoqerise ARMO Sha
Mbeshtetja e investimeve ne prodhimin e energjise ne jug te vendit	Rritja e kapaciteteve prodhuese te energjise elektrike nga TEC-et ekzistues
Integrimi i Shqiperise ne rrjetet e transmetimit rajonal dhe europian te energjise.	Fillimi i zbatimit te projekteve per lidhjen e Shqiperise me rrjetin e naftesjellesave nderkombetare (AMBO) dhe gazesjellesave (Projekti EGL) Ndjekja e procedurave per fillimin e punimeve ne linjen 400 kV te interkonjeksionit Elbasan-Podgorice
Konkurrence e lire dhe e ndershme ne tregun e hidrokarbureve	Procedurat ligjore per te bere te mundur nxitjen e itneresit per ndertimin e depozitave te GLN ne qarkun e Fierit Kuadri ligjor dhe teknik per tregun e gazit natyror ne Shqiperi
Reduktimi i peshes se ekonomise informale	Plan masash konkrete per reduktimin e ekonomise informale
Rritja e konkurueshmerise dhe kapja e tregjeve per eksport	Eksporte te rritura Fondi per rritjen e konkurueshmerise per SME-te qe eksportojne
Rritja e kreditimit dhe zgjerimi I mikrokredise	SME te fuqizuara, te kredituara dhe me konkruese Kreditim i garantuar per SME-te
Te drejtat e konsumatorit	Mbeshtetja e shoqates konsumatoreve Siguri e rritur per mallrat e sherbimet ne treg
Reduktimi I barrierave administrative	Reduktim I kohes e koston se rregjistrimit te biznesit Reduktim te numrit te licencave, lejeve, a utorizimeve te panevojshme dhe lehtesim procedurash Kuader rregullator i permiresuar
Partneritet publik-privat bazuar ne rregullat e tregut te lire e te konkurrences se ndershme	Krijimit i Sekretariatit te Keshillit Konsultativ te Biznesit Dhenien me koncension me cmim simbolik 1 Euro te TEC-eve qe jane prej vitesh jashte pune

Aneks 3 Rezultate që lidhën me integrimin European

Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA	Outputet
Pjesëmarrje në grupet e punës për rishikimin e strategjisë kombëtare të energjisë	Hartimi i strategjisë kombëtare të energjisë
Permiresimi i kuadrit ligjor për hapjen dhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike	VKM për miratimin e Modelit të Tregut të energjisë elektrike Rishikimi i Kodit të Transmetimit dhe kodeve të tjera.
Bashkëpunimi me shoqëritë e huaja për kërkimin dhe prodhimin e HK në territorin Shqiptar	Percaktimi i metodave optimale për shfrytëzimin e vendburimeve të naftës dhe gazit si dhe llogaritjen e rezervave të nxjerrshme të tyre sipas standarteve të BE-se.
Diversifikimi i burimeve të furnizimit me naftë, gas dhe nenprodukte	Fillimi i zbatimit të projekteve për lidhjen e Shqipërisë me rrjetin e naftës/jellesave ndërkombëtar (AMBO) dhe gazsjellesave (Projekti EGL). Miratimi i të gjitha procedurave ligjore për të bërë të mundur nxitjen e interesit për ndërtimin e depozitave të GLN në qarkun e Fierit
Rritja e rolit rregullator të shtetit në drejtim të çelësive të nenprodukteve që tregtohen, rezervës së sigurisë	Ndërtimi i kuadrit ligjor dhe teknik për tregun e gazit në territorin shqiptar
Hartimi i programit strategjik 2006-2009 për SME-te	Plani strategjik afatmesëm për zhvillimin e SME-ve si dhe vlerësimi i kostos për zbatimin e planit
Krijimi i Sekretariatit të Këshillit Konsultativ të Biznesit me qëllim nxitjen e dialogut Qeveri-Biznes	Institucionalizimi i dialogut Qeveri-Biznes
Rishikimi i strategjisë së nxitjes së investimeve të huaja	Miratimi i strategjisë për zhvillimin e biznesit dhe investimeve
Studim për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-se, në fushën e SME, eksporteve dhe IHD	Adoptim i kuadrit ligjor në fushën e SME-ve dhe biznesit em direktivat e BE-se
Studim për vlerësimin e kostove për zbatimin e programit strategjik të zhvillimit të SME-ve	Realizimi i studimit
Vlerësimi dhe monitorimi i planit të veprimit për reduktimin e ekonomisë informale	Hapa konkrete drej reduktimit të ekonomisë informale
Fimi i zbatimit të projektit "Për mbështetjen e SME-ve" duke menaxhuar programin 3-vjeçar për mbështetjen e SME-ve	Krijimi i fondit të garantimit për SME-te
Krijimi i Qendres Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit	Qendra Kombëtare e Regjistrimit, funksionale
Rishikimi i modelit të regjistrimit të biznesit me objektiv reduktimin e kohës së regjistrimit të biznesit dhe ofrimin e regjistrimit on line	Aplikimi i modelit të regjistrimit në 29 bashki brenda 2007
Rishikimi i Planit të veprimeve për vitin 2007 për Reformën rregullatore në funksion të permiresimit të klime së biznesit	Plani i ri i Veprimit i miratuar nga KM
Përgatitja e hapave të nevojshëm për strategjinë përfundimtare të RIA-s	Dokumenti i politikave për zbatimin e RIA-s në Shqipëri
Strategjia afatgjate për Mbrojtjen e Konsumatoreve dhe Mbikqyrjen e Tregut	Miratimi i Strategjisë
Kuadri ligjor për institucionalizimin e Sistemit të Mbikqyrjes së Tregut	Miratimi i paketës ligjore përkatëse
Harmonizimi i legjislacionit teknik për levizjen e lire të mallrave dhe shëbimeve	Aprovimi nga KM i rregullave teknike për tre grupe produktesh
Fushatë sensibilizuese për konsumatorët shqiptarë	Mbështetja e shoqatave të konsumatoreve në Shqipëri nëpërmjet trajnimeve, programeve apo forma të tjera mbështetjeje
Hartimi i preventivave të ndryshme për rimbylljet; hartimi i projekteve për mbyllje të reja	Miniera të mbyllura

Aneks 4 Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO

Ne fushen e privatizimit

- Ristrukturimi i KESH Sh.a. dhe fillimi i procedurave për privatizimin e sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike
- Ristrukturimi dhe privatizimi i shoqërisë "Armo" Sh.a
- Ristrukturimi dhe privatizimi i Servcom sh.a & "Albpetrol" Sh.a
- Vazhdimi i kontratës së koncesionit të Ujesjellës-kanalizime Elbasan (Elber shpk)
- Privatizimi i paketës shtetërore në shoqërinë AMC

Ne fushen e reduktimit të ekonomisë informale

- Përmirësimi i identifikimit dhe matjes së ekonomisë informale në afat të mesëm (2007 - 2009)
- Rritja e numrit të të siguruarve, nivelit të pagave si dhe studimi i tregut të punës dhe bilanceve të fuqisë punëtore
- Përmirësimi i performancës në ekzekutimin e detyrave dhe rritja e përgjegjësisë në ekzekutimin e detyrave nga inspektorët e taksave dhe të punës

Aneks 5 Investimet publike

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	
Blerje pajisje per zyrat dhe kosto lokale	26
Mbeshtetje per energjine	
Agjencia Kombetare e Energjise: Monitorimi strategjise se eficences	15
Policia Elektrike: Blerje pasije dhe riparime	5
Mbeshtetje gjeoshkenca e te tjera	
Sherbimi Gjeologjik Shqiptar	182
Agjencia Kombetare Burimeve Natyrore	40
Mbeshtetje miniera e ndermarrje publike	
Reparti Inspektim Shpetimit Minerave: Rikonstruksion i ambienteve te zyrave dhe paisje shpetimi	13
Albkromi: Mbyllje dhe konservim	11
Albbakri: Mbyllje dhe konservim	12
Miniera e Qymyrgurit Mborje Drenove: Mbyllje dhe konservim	3
Miniera Qymyrgurit Gore: Mbyllje dhe konservim	3
Miniera Qymyrgurit Pogradec: Mbyllje dhe konservim	3
Miniera Qymyrgurit Krrabe: Mbyllje dhe konservim	1
Miniera Qymyrgurit Priske: Mbyllje dhe konservim	2
Miniera Qymyrgurit Myshqeta: Mbyllje dhe konservim	1
Miniera Qymyrgurit Memaliaj: Mbyllje dhe konservim	2
Miniera e Hekur Nikelit Guri kuq Pog: Mbyllje dhe konservim	3
miniera hekur Nikelit Prrenjjas: Mbyllje dhe konservim	3
NFIM Elbasan: Mbyllje dhe konservim	7
Miniera Nikel Silikatit Bitincke: Mbyllje dhe konservim	1
NNMetalifere: Mbyllje dhe konservim	1
Uzina e Plerave Azotike Fier: Mbyllje dhe konservim	3
Uzina e Superfosfatit Lac: Mbyllje dhe konservim	1
Ndermarrja e Gomes Durres: Mbyllje dhe konservim	1
Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	
Agjencia Shqiptare e Biznesit e Investime: Studimi I tregut mbi menaxhimin e pasurive	2
Agjencia Shqiptare e Biznesit e Investime: Observatori i SME-ve per vleresimin e situates	3
Agjencia Shqiptare e Biznesit e Investime: Implementimi i strategjise per krijimin e parqeve	2
Agjencia Shqiptare e Biznesit e Investime: Implementimi i strategjise per menaxhimin e pasurise	2
Agjencia Shqiptare e Biznesit e Investime: Strategji per thithjen e investitoreve te huaj	3
Agjencia Shqiptare e Biznesit e Investime: Studim tregu ne ndihme te eksporteve	2
Agjencia Shqiptare e Biznesit e Investime: Studime te tjera per investimet	12
Agjencia Shqiptare e Biznesit e Investime: Krijimi i data base	1
Agjencia Shqiptare e Biznesit e Investime: TVSH dhe taks doganore	30
Sherbimet e tregut, akreditim dhe inspektim	
Drejtoria e Akreditimit	5
Inspektoriati Qendrore Teknik	7
Drejtoria Patentave dhe Markave	1

Aneks 6 Projekte të ndihmës së huaj

Emri i projektit	Donatori	Kosto totale (ne milion leke)	Data e mbarimit
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi			
Legjislacioni ekonomik	GTZ	6	2008
Mbeshtetje per zhvillim ekonomik			
Business Environment Reform and Institutional Strengthening Project	Banka Boterore	632	2010
Programi per mbeshtetjen e SME-ve	Qeveria Italiane	3750	2010
Programi i zhvillimit ekonomik dhe nxitja e punesimit	GTZ	250	2009
Regjistrimi i bizneseve	Millennium Challenge Account / USAID	250	2008
Sherbimet e tregut, akreditim dhe inspektim			
Fuqizimi i kapaciteteve ne fushen e ndihmes shteterore	CARDS 2005	25	2008
Metrologjia ne Shqiperi	CARDS 2003	162	Gusht 2007
Mbikeqyrja e tregut	CARDS 2003	125	Qershor 2007
Support to standards, certification and accreditation	CARDS 2003		

